

KARTELË INFORMATIVE

AL011093

1. Emri i shërbimit	Kërkesë për rivendosjen në afat të modelit të përdorimit			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Kur aplikanti ose pronari i një modeli përdorimi, pavarësisht nga vullneti, por për shkak të rrethanave të krijuara, nuk ka qenë në gjendje të respektojë afatin kundrejt Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI), mund të kërkojë rivendosjen e së drejtës, nëse mosrespektimi i këtij afati ka si pasojë të drejtpërdrejtë refuzimin e aplikimit për patentë apo të një kërkesë tjetër, vlerësimin e aplikimit si të dorëhequr, humbjen e ndonjë të drejte tjetër ose të mjeteve për mbrojtjen e të drejtave.			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Në kërkesën për rivendosjen e së drejtës përcaktohen arsyet që kanë penguar aplikuesin të respektojë afatin. Kërkesa shoqërohet me pagesën e tarifës përkatëse dhe depozitohet brenda afatit të përcaktuar në ligj. Nëse kërkesa pranohet, pasojat ligjore për shkak të mosrespektimit të afatit, vlerësohen se nuk kanë ndodhur.			
4. A jam përfitues?	Individ, Person fizik apo juridik, biznes, OJF, Institucion, Universitet, Qendra Kërkimore dhe kushdo që ka një model përdorimi.			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
	1	Formulari i aplikimit për rivendosje në afat	Aplikanti/ Intitucioni	Po
	2	Mandatpagesa e tarifës për rivendosje në afat	Banka	Po
	3	Shkaqet që çuan në mosrespektimin e periudhës së prioritetit, pavarësisht marrjes së masave të nevojshme	Aplikanti	Po
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse	Qyteti	Adresa	Orari
	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)	Tiranë	Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona Nr. 33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë	E hënë - e enjte, ora 8:00 - 16:30 E premte, ora 8:00 - 14:00
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
	Ofrohet informacion mbi shërbimin	Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Shërbimi ofrohet tërësisht online
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë	Tarifa shtesë	Tarifa Online	Mënyra e pagesës
	2 000 lekë			Në një bankë (ose në disa banka), jashtë institucionit
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	3 muaj nga data e plotësimit të dokumentacionit			
10. Çfarë përfitoj?	Njoftim			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	Pa afat			
12. Ku e marr?	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input checked="" type="checkbox"/>	E-albania <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)			
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	Kontakto në:		Orari	
	E-albania: e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al DPPI web: www.dppm.gov.al Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118		Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: E hënë - e premte, ora 08:00 - 19:00	
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input type="checkbox"/>	Web-i i Institucionit <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>
	Në platformën "Shqipëria që duam" Link: www.shqiperiaqeduam.al		<input checked="" type="checkbox"/>	
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	Ligji Nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar; VKM Nr. 1707 datë 29.12.2008 "Për miratimin e rregullores "Për lëshimin e patentave për shpikje dhe modelet e përdorimit", e ndryshuar; VKM Nr. 883, datë 13.05.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale", i ndryshuar.			